



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 601, Datë 21.03.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve me të drejtë vote nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve me të drejtë vote nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA.

VËREN SE :

Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Tosk Energji SHA nga shoqëria Skysea

B.V.

Pala Blerëse: Skysea B.V, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës , me objekt veprimtarie tregti e energjisë elektrike dhe gazit nëpërmjet tubave, etj. Skysea B.V kontrollohet plotësisht nga Gunvor Group Ltd e cila është shoqëri tregtare që operon në mbi 100 vende për tregtimin e lendeve të para.

Shoqëria blerëse Skysea BV dhe mëma e saj Gunvor Group LTD nuk janë aktive në tregun shqiptar.

Pala Shitëse: CFD Conseils Sàrl, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Zvicrës, me objekt veprimtarie këshillim, asistencë, ndërmjetësim financiar dhe ofrim shërbimesh në sektorin e lëndëve të para etj.

Shoqëria Target: Tosk Energji SHA, është një shoqëri e themeluar më datë 11.06.2015 sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie nxjerrje, shfrytëzim, përpunim i naftës bruto dhe nën produkteve të saj, import – eksport, etj.

Shoqëria zotërohet nga në 100% të aksioneve të saj nga shoqëria CFD Conseils Sàrl.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përfitim kontrolli mbi 50% të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Tosk Energji nga shoqëria Skysea B.V. Pas kryerjes së transaksionit shoqëria Skysea BV dhe shoqëria CFD Conseils Sàrl do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Tosk Energji SHA.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit u konsiderua tregu i furnizimit dhe shitjes me shumicë të karburante dhe tregu përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Nga analiza e të dhënave, konstatohet se shoqëria Gunvor zotëron rreth XX% të tregut të furnizimit me karburante në MLD dhe shoqëria Tosk Energji SHA XX % të tregut. Transaksioni i blerjes së 50% të kapitalit me të drejtë vote të Tosk Energji SHA nga Skysea BV nuk do të sjellë ndryshime në tregun e furnizimit me karburante për shkak të pjesës shumë të vogël të tregut që zotëron shoqëria Tosk Energji SHA.

Në tregun e shitjes me shumicë, shoqëria Gunvor SA nuk ushton aktivitet dhe sipas të dhënave të administruara nga DPD për vitin 2017 as shoqëria Tosk Energji nuk ka regjistruar zhdoganime për karburante gjatë vitit 2017.

Duke qenë se Gunvor SA dhe Tosk Energji SHA veprojnë në segmente të ndryshme të tregtimit të karburanteve, transaksioni i synuar nuk do të ndikojë në pjesën e tregut të shoqërisë Tosk Energji SHA.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve të shoqërisë Tosk Energji SHA nga shoqëria Skysea B.V.
2. Monitorimin e tregut të furnizimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për një periudhë 1 vjeçare nga dalja e këtij vendimi dhe detyrimin e shoqërisë Tosk Enejji SHA për të raportuar çdo 3 muaj treguesit ekonomik e financiarë pranë Autoritetit të Konkurrencës.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS